

## 5. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË 2018-2020

*Strategjia afatmesme e zhvillimit paraqet ambicien e Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018-2020. Dokumenti synon t'u japë një përgjigje proaktive sfidave të mjedisit ku operon Banka e Shqipërisë; të rrisë bashkëpunimin brenda institucionit; të nxisë përdorimin efektiv dhe eficient të burimeve; si dhe të promovojë transparencën dhe llogaridhënien publike.*


Ky dokument është një përditësim i Strategjisë 2016–2018, përmes së cilit zgjatet afati i zbatimit të saj, përtej vitit 2018 dhe përcaktohen objektivat kryesorë për periudhën trevjeçare në vijim. Shtrirja e kohëzgjatjes së zbatimit siguron mbështetjen e duhur programatike për buxhetin orientues afatmesëm të Bankës së Shqipërisë për vitet 2019 dhe 2020.

Zgjatja e afatit reflekton njëkohësisht edhe objektivat afatmesëm të realizuar deri më sot, të cilët nuk figurojnë më në përmbajtjen e Strategjisë. Aty ku ka qenë e nevojshme, janë parashikuar objektiva të rinj për periudhën 2019-2020, ose janë përditësuar objektivat ekzistues. Përcaktimi i objektivave të rinj ka qenë i domosdoshëm në fusha të tilla si ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka apo administrimi i rrezikut operacional, të cilat janë të reja për Bankën e Shqipërisë.

Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë ka adoptuar modelin e një numri bankash të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, të cilat kanë një sistem të dyfishtë planifikimi strategjik: (i) një proces madhor planifikimi, një herë në 3-5 vjet; dhe (ii) një proces (minor), të përvitshëm, përditësimi.

Strategjia 2018-2020 mban të pandryshuar misionin, vizionin dhe vlerat kryesore të institucionit, të cilat përbëjnë pikënisjen e dokumentit. Misioni shpreh arsyen e ekzistencës së Bankës së Shqipërisë dhe qëllimit bazë drejt të cilit orientohen veprimtaritë e saj. Vlerat përmbledhin parimet e përbashkëta që janë pjesë e kulturës së Bankës së Shqipërisë dhe orientojnë sjelljen e punonjësve. Vizioni qartëson drejtimin e Bankës së Shqipërisë dhe mënyrën si institucioni kërkon të perceptohet nga bota e jashtme (d.m.th. institucionet shtetërore, sistemi bankar dhe publiku).

Objektivat e Strategjisë rrjedhin nga ligji organik dhe përcaktojnë prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë në përmbushjen e misionit dhe vizionit. Implementimi i objektivave bazohen tek: (i) burimet njerëzore: aftësitë, talenti dhe njohuritë e punonjësve; (ii) teknologjia e informacionit: bazat e të dhënave, sistemet e informacionit, rrjetet dhe infrastruktura e teknologjisë; dhe (iii) organizimi i brendshëm: kultura, drejtimi, punonjësit dhe puna në grup.



Sfidat kryesore me të cilat do të përballlet Banka e Shqipërisë gjatë periudhës trevjeçare në vijim janë:

#### **a) Ruajtja e stabilitetit monetar**

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë vazhdon të orientohet drejt mbajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe synon forcimin e bashkëpunimit me partnerët brenda dhe jashtë vendit, përmes një bashkërendimi më të mirë të politikave makroekonomike dhe shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës.

Operacionet e Bankës së Shqipërisë synojnë rritjen e fleksibilitetit të instrumenteve për zbatimin e politikës monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Prioritet mbetet zhvillimi i mëtejshëm i tregut të parasë dhe i tregut sekondar të titujve të Qeverisë, si dhe përmirësimi i infrastrukturës së AFISaR.

#### **b) Garantimi i një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe eficient**


Zbatimi i Strategjisë së Politikës Makroprudenciale synon ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin dhe trajtimin e rrezikut sistemik. Puna e Bankës së Shqipërisë në vijim do të synojë finalizimin e përcaktimit të treguesve dhe të niveleve kritike për disa tregues të rreziqeve sistematike, me qëllim operacionalizimin e instrumenteve makroprudenciale dhe përgatitjen e metodologjive përkatëse. Në të njëjtën kohë do të punohet për pasurimin dhe konsolidimin e bazave të të dhënave dhe formave të raportimit, harmonizimin e analizave dhe treguesve që përdoren nga njësitë e ndryshme organizative brenda Bankës së Shqipërisë, si dhe forcimin e kapaciteteve analitike dhe modeluese. Veçanërisht, do të punohet për qartësimin e marrëdhënies midis politikave makroprudenciale e mikroprudenciale me politikën monetare, me fokus shkëmbimin dhe analizimin e informacionit të rëndësishëm, si dhe ndërveprimin në vendimmarrjet përkatëse.

#### **c) Sigurimi i një veprimtarie bankare të shëndetshme**

Mbikëqyrja bankare ka në fokus sigurimin e një sistemi financiar të sigurt e të shëndetshëm, që garanton besimin e qytetarëve dhe kontribuon në rritjen ekonomike të qëndrueshme. Zhvillimi i kuadrit rregullator orientohet drejt standardeve të Bazelit dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, do të punohet për konsolidimin e procesit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të subjekteve të mbikëqyrura.

#### **d) Adresimi i problemeve të mundshme të bankave në vështirësi financiare**

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë synon realizimin e ndërhyrjeve të organizuara në bankat me paftësi paguese, duke minimizuar ndikimet në ekonominë reale, financat publike dhe stabilitetin financiar. Puna fokusohet në ngritjen e kuadrit rregullator, hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, plotësimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe bashkërendimin e veprimeve me institucionet e tjera vendase dhe të huaja.



**e) Rritja e cilësisë së të dhënave statistikore**

Objektivat në fushën statistikore orientohen drejt plotësimit të standardeve sasiore të metodologjive ndërkombëtare dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe përmbushjes së kriterëve të cilësisë së të dhënave, sipas standardeve ndërkombëtare.

**f) Përmirësimi i cilësisë së parasë**

Një objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë është ruajtja e cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim, me qëllim rritjen e besueshmërisë së publikut të para. Kjo do të realizohet, ndër të tjera, përmes prodhimit të kartëmonedhave të reja, të ridizenjuara dhe me elemente sigurie në nivele të avancuara teknologjike.

**g) Forcimi i mirëqeverisjes së institucionit**

Forcimi i mirëqeverisjes nënkupton, krahas konsolidimit të pavarësisë së institucionit, në përputhje me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, edhe rritjen e llogaridhënies në lidhje me përmbushjen e detyrave, burimet fizike, njerëzore dhe financiare.

Si një objektiv kryesor në fushën e llogaridhënies përcaktohet edhe administrimi i rrezikut operacional. Ky nënkupton një përqaasje të strukturuar, sistematike dhe gjithëpërfshirëse për adresimin e rrezikut jofinanciar me të cilin përballet institucioni në të gjitha fushat e veprimtarisë.

Një tjetër aspekt i mirëqeverisjes, i lidhur ngushtë me konceptin e llogaridhënies, është transparencja. Objektiv i kryesor i Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim është zgjerimi i informacionit dhe përmirësimi i kanaleve të komunikimit me publikun dhe grupet e interesit, në funksion të rritjes së besueshmërisë së institucionit dhe efikasitetit të politikës monetare.

**h) Burimet e Bankës së Shqipërisë**

Banka e Shqipërisë po vijon punën e nisur për rikonstruktimin e ish-Hotel Dajtit. Vënia në përdorim e ndërtesës do të mundësojë akomodimin në kushte optimale të gjysmës së personelit të Bankës së Shqipërisë.

